

VENDIM
Nr. 194, datë 26.3.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT, AFATEVE,
PROCEDURËS SË KONKURRIMIT DHE METODOLOGJISË SË PIKËZIMIT PËR
DHËNIEN E LICENCËS PËR KATEGORINË E BASTEVE SPORTIVE *ONLINE***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 27/2, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë kriteret e vlerësimit, afatet, procedurën e konkurrimit dhe metodologjinë e pikëzimit së subjekteve për dhënie e licencës për kategorinë e basteve sportive *online*, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

KREU II
KRITERET E VLERËSIMIT DHE METODOLOGJIA
E PIKËZIMIT TË APLIKIMEVE

Neni 2
Kriteret e vlerësimit dhe metodologjia e pikëzimit të aplikimeve

1. Dokumentacioni i paraqitur nga aplikantët vlerësohet me pikë, sipas kriterëve të mëposhtme dhe peshës maksimale për secilin kriter:

a) Oferta ekonomike, vlera e ofruar nga aplikanti mbi tarifën e licencimit për bastet sportive *online*, 30 pikë;

i. Vlerësimi i këtij kriteri bëhet në përputhje me përcaktimet e nenit 22, të ligjit nr. 155/2015.

ii. Pikëzimi i këtij kriteri bëhet sipas metodologjisë, si më poshtë vijon:

Pikët maksimale për kriter janë 100 pikë. Propozimi që ofron vlerën më të lartë përfiton pikët maksimale të atij kriteri. Propozimet e tjera marrin pikë në përqindje të vlerës më të lartë të ofruar, sipas formulës:

Pikët për kriterin = $100 \times (\text{Vlera e ofruar nga propozimi} / \text{Vlera më e lartë e ofruar për atë kriter})$.

b) Përvoja në fushën e lojërave të fatit, 30 pikë;

i. Vlerësimi i këtij kriteri bëhet në përputhje me përcaktimet e shkronjës “ç”, të pikës 1, të shkronjës “c”, të pikës 2, dhe të pikës 6, të nenit 22, të ligjit nr. 155/2015, mbi bazën e dokumentacionit provues, të paraqitur nga aplikuesi ose aksionari që përmbush kushtin e përvojës.

ii. Pikëzimi i këtij kriteri bëhet sipas metodologjisë, si më poshtë vijon:

Pikët maksimale për kriter janë 100 pikë. Propozimi që ofron vlerën më të lartë përfiton pikët maksimale të atij kriteri. Propozimet e tjera marrin pikë në përqindje të vlerës më të lartë të ofruar, sipas formulës:

Pikët për kriterin = $100 \times (\text{Vlera e ofruar nga propozimi} / \text{Vlera më e lartë e ofruar për atë kriter})$.

c) Plani i biznesit për aktivitetin e basteve *online*, 5 pikë;

i. Vlerësimi i këtij kriteri kryhet në përputhje me shkronjën “e”, të pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr. 155/2015, mbi bazën e analizës së dokumentacionit provues të paraqitur, duke mbuluar një periudhë jo më pak se 3 (tre) vjet dhe duke përfshirë në mënyrë të qartë mënyrën e zhvillimit të aktivitetit.

ii. Plani i biznesit vlerësohet në mënyrë të integruar, duke përfshirë analizën e tregut dhe strategjinë (pozicionimin konkurrues, hyrjen dhe zhvillimin në treg), modelin operacional dhe realizueshmërinë e tij gjatë periudhës trevjeçare, analizën financiare (modelin e të ardhurave, strukturën e kostove, parashikimet, fluksin e parasë dhe pikën e barazimit), identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve të tregut, financiare, ligjore dhe operacionale si dhe mënyrën e marrëdhënies me klientët.

iii. Vlerësimi do të jetë krahasues dhe proporcional, duke garantuar trajtim të barabartë dhe objektiv të aplikuesve. Komisioni i Licencave mund të kërkojë informacion shtesë dhe të kryejë verifikime për të konfirmuar saktësinë dhe funksionalitetin e kapaciteteve të deklaruara.

ç) Kapacitetet organizative dhe administrative, 20 pikë;

i. Vlerësimi i këtij kriteri kryhet në përputhje me pikën 5, të nenit 22, të ligjit nr. 155/2015, mbi bazën e një vlerësimi të kombinuar sasior dhe cilësor, që analizon mjaftueshmërinë, funksionalitetin, qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e kapaciteteve të deklaruara. Në këtë kuadër merren në konsideratë, në veçanti, struktura organizative dhe vendimmarrëse, në raport me kompleksitetin e aktivitetit; sistemi i kontrollit të brendshëm, llogaridhënies dhe menaxhimit të riskut; kapacitetet e burimeve njerëzore dhe organizimi i përgjegjësive; politikat e rekrutimit, zhvillimit dhe vlerësimit të performancës; efektiviteti i proceseve operacionale dhe mekanizmat e raportimit/auditimit; struktura e kontrollit financiar dhe integriteti i transaksioneve; si dhe aftësia për përmbushjen e detyrimeve financiare ndaj shtetit dhe lojtarëve.

ii. Vlerësimi bazohet në dokumentacion zyrtar provues dhe çdo evidencë tjetër mbështetëse që demonstroi ushtrimin e ligjshëm dhe të qëndrueshëm të aktivitetit. Komisioni i Licencave mund të kërkojë informacion shtesë, si dhe të kryejë verifikime teknike për të konfirmuar funksionalitetin real të kapaciteteve të deklaruara.

d) Kapacitetet për zgjidhjen *software*-ike të përdorur, modelet e licencave, standardet apo certifikimet e njohura ndërkombëtare, 15 pikë.

i. Vlerësimi i këtij kriteri kryhet në përputhje me pikat 7 dhe 8, të nenit 22, të ligjit nr. 155/2015, mbi bazën e dokumentacionit provues të paraqitur nga aplikuesi dhe nëpërmjet një vlerësimi të kombinuar sasior dhe cilësor. Në këtë kuadër merren në konsideratë, në veçanti zgjidhjet *software*-ike dhe arkitektura teknike, përfshirë përmbushjen e kërkesave ligjore, integrimin me sistemet e monitorimit të AMLF-së dhe garantimin e aksesit në kohë reale, si dhe aspektet e shkallëzueshmërisë, sigurisë kibernetike, mbrojtjes së të dhënave dhe mekanizmave të rikuperimit; modeli i licencimit të *software*-it dhe qëndrueshmëria e marrëdhënies kontraktore, përfshirë garancitë për vazhdimësinë e shërbimit dhe shmangien e varësisë disproporcionale nga furnizuesi; standardet dhe certifikimet ndërkombëtare të sigurisë dhe cilësisë, si dhe verifikimet e pavarura të sistemit; si dhe mbështetja teknike e mirëmbajtja, përfshirë marrëveshjet SLA, përditësimet periodike dhe disponueshmërinë e dokumentacionit teknik.

ii. Vlerësimi bazohet në prova dokumentare zyrtare, si licenca të vlefshme, raporte rregullatore, certifikime teknike dhe referenca institucionale, si dhe çdo dokument tjetër që

provon ushtrimin e ligjshëm dhe të qëndrueshëm të aktivitetit. Komisioni i Licencave mund të kërkojë dokumentacion shtesë, prova teknike ose demonstrim funksional për të verifikuar kapacitetet e deklaruara.

2. Pikët për të gjitha kriteret mblidhen për të llogaritur pikët totale të secilit propozim. Pikët maksimale që mund të marrë një propozim janë 100.

3. Pas llogaritjes së pikëve për secilin propozim, subjekti ose subjektet aplikues/aplikuese renditen në rendin zbritës sipas pikëve që kanë marrë propozimet e tyre. Propozimi më i mirë i vlerësuar është propozimi që ka marrë më shumë pikë në vlerësim.

4. Në rast se dy ose më shumë propozime rezultojnë me pikë të njëjta, renditja e tyre përcaktohet me short. Njoftimi për datën dhe orën e hedhjes së shortit u njoftohet aplikantëve nga Komisioni i Licencave. Mospjesëmarrja e aplikantëve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për skualifikim.

KREU III ORGANIZIMI I PROCEDURËS KONKURRUESE DHE DOKUMENTET

Neni 3

Procedura konkurruese

1. Procedura konkurruese për dhënien e licencave për bastet sportive *online* zhvillohet me një fazë, ku aplikantët paraqesin në aplikimin e tyre të gjithë dokumentacionin për plotësimin e kriterëve të parashikuara në nenin 22, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Licenca i jepet subjektit ose subjekteve aplikues/aplikuese që plotëson/plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj dhe janë renditur në listën fituese sipas rendit zbritës të pikëve të marra.

Neni 4

Autoriteti organizues dhe rregullat e procedurës konkurruese

1. Me anë të procedurës konkurruese bëhet përzgjedhja e subjektit/ve për dhënien e licencës për lejimin e organizimit të basteve sportive *online*, të cilat janë të kufizuara në numër në rang kombëtar, jo më shumë se 10 (dhjetë), në të cilën ka të drejtë të konkurrojë çdo subjekt i interesuar që plotëson kriteret e parashikuara në nenin 22, të ligjit nr. 155/2015, dhe paraqet ofertën më të favorshme.

2. Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF), Komisioni i Licencave i ngritur në bazë të nenit 17/1, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe sekretariati teknik pranë tij organizojnë procedurat konkurruese dhe vlerësuese sipas detyrave përkatëse, të përcaktuara në ligj dhe në këtë vendim.

Neni 5

Hapja e procedurës konkurruese dhe njoftimi i thirrjes për konkurrim

1. Komisioni i Licencave merr vendim për hapjen e një procedure konkurruese dhe numrin e licencave që do të jepen në thirrje.

2. Brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e vendimit për hapjen e një procedure konkurruese nga Komisioni i Licencave, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit publikon njoftimin për konkurrim për dhënien e licencës për ofrimin e “Basteve sportive *online*” në faqen e saj zyrtare të internetit, në 2 gazeta ndërkombëtare, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike.

3. Njoftimi duhet të përmbajë të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e aplikimeve nga ana e subjekteve aplikuese të cilat kërkojnë të pajisen me licencë për kryerjen e aktivitetit të lojës së fatit “Baste sportive *online*”. Njoftimi i thirrjes për konkurrim përmban:

- a) listën e dokumentacionit;
- b) vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumenteve;
- c) gjuhën e paraqitjes së dokumenteve;
- ç) mënyrën e paraqitjes së dokumenteve;
- d) vendin, datën dhe orën e shqyrtimit të dokumenteve.

4. Përveç njoftimit të thirrjes për konkurrim, AMLF-ja publikon listën e dokumentacionit për zhvillimin e procedurës konkurruese, si më poshtë vijon:

- a) Udhëzimet për subjektet/aplikantët që përmbajnë:
 - i. informacionin për përgatitjen e aplikimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj dhe këtë vendim sipas formateve përkatëse të njoftuara në thirrje;
 - ii. informacionin për përballimin e kostove të aplikimit nga ana e tyre;
 - iii. mënyrën e dhënies së informacionit për të gjitha subjektet/të gjithë aplikantët që mund të kërkojnë sqarime për dokumentacionin e procedurës së konkurrimit;
 - iv. informacion lidhur me ndryshimet e mundshme të dokumentacionit të aplikimit si rezultat i kërkesave për sqarim nga aplikantët, si dhe mënyrën e vendin e publikimit të tyre;
 - v. çdo informacion tjetër të nevojshëm për zhvillimin e procedurës konkurruese në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.
- b) Kriteret e parashikuara në nenin 22, të ligjit nr. 155/2015, si dhe kriteret e vlerësimit dhe metodologjinë e pikëzimit të aplikimeve, sipas nenit 2, të këtij vendimi;
- c) Formularin për deklarin e konfliktit të interesit;
- ç) Formularë vetëdeklarimi;
- d) Formularin e ofertës ekonomike;
- dh) Formularin e skualifikimit;
- e) Formularin e publikimit të njoftimit të fituesit;
- ë) Formularin e paraqitjes së ankesave.

Neni 6

Përgatitja e aplikimeve dhe udhëzimet për subjektet aplikuese

1. Aplikimet paraqiten vetëm nga persona juridikë të regjistruar si shoqëri aksionare. Në rast të aplikimit të paraqitur nga një bashkim personash juridikë, aplikimi duhet të shoqërohet me prokurën/autorizimin me shkrim për personat e autorizuar, që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së konkurrimit.

2. Aplikanti ka detyrimin ligjor të paguajë një tarifë aplikimi për aplikimin e tij në vlerën 500 000 (pesëqind mijë) lekë në favor të AMLF-së, tarifë e cila nuk kthehet pavarësisht aplikimit të suksesshëm ose jo të subjektit aplikues. Pagesa e tarifës së aplikimit kryhet në llogarinë e AMLF-së, e përcaktuar në njoftimin e procedurës konkurruese nga llogaria e subjektit aplikues apo anëtarit të autorizuar nëse subjekti aplikues është bashkim personash juridikë.

3. Aplikantët duhet të përgatisin aplikimin në përputhje me dokumentin e aplikimit, të publikuar sipas mënyrës së përcaktuar në njoftimin e procedurës konkurruese dhe të përballojnë me shpenzimet e veta të gjitha kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e tyre. Dokumentet që përbëjnë aplikimin nuk u kthehen aplikantëve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës së konkurrimit.

4. Aplikimi duhet të futet në një zarf të jashtëm, jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe të firmosur, ku të jetë shënuar: “Aplikim për licencë” dhe duhet:

- a) të mbajë emrin dhe adresën e aplikantit;

b) t'i drejtohet Komisionit të Licencave pranë AMLF-së, në adresën e dhënë në njoftimin e procedurës së konkurrimit;

c) të mbajë shënimin “Mos e hap përpara [ora dhe data]”, për t'u plotësuar me orën dhe datën e specifikuar në njoftimin e konkurrimit.

5. Aplikanti përfshin në aplikimin e tij edhe një kopje të të gjithë dokumentacionit në format elektronik, të ruajtur në një CD, si dhe një kopje të aplikimit në format shkresor. Kopja e aplikimit do të qëndrojë e mbyllur dhe do të hapet vetëm në rast të shqyrtimit të ndonjë ankese në lidhje me dorëzimin e dokumentacionit të paraqitur në aplikim.

6. Nëse zarfi i jashtëm i aplikimit nuk është i mbyllur dhe i emërtuar, siç kërkohet në këtë vendim, dhe nuk paraqitet sipas udhëzimeve të aplikimit, autoriteti organizues i procedurës konkurruese nuk do të marrë asnjë përgjegjësi për përmbajtjen e dokumentacionit të paraqitur.

7. Aplikimi i paraqitur nga subjekti aplikues duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose kopje e njësuar me dokumentin origjinal, ose me nënshkrim/vulë elektronike në rastin kur këto aplikohen. Vërtetimet, deklaratat dhe certifikatat duhet të jenë lëshuar jo më parë se 3 (tre) muaj nga data e dorëzimit të aplikimit nga subjekti aplikues. Dokumentet duhet të dorëzohen në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

8. Subjekti aplikues ka të drejtën të depozitojë edhe dokumente në gjuhë të huaj, të shoqëruara me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe. Aktet zyrtare të juridiksioneve të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe.

9. Subjekti aplikues ka të drejtë të kërkojë sqarime për dokumentacionin e aplikimit. Kërkesa për sqarime duhet të paraqitet me shkrim në adresën elektronike të kontaktit, të publikuar në njoftimin e procedurës së konkurrimit, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë para përfundimit të afatit të dorëzimit të aplikimeve. Përgjigjja përkatëse e Komisionit të Licencave jepet, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës, duke e publikuar në faqen zyrtare të AMLF-së, pa identifikuar burimin e kërkesës. Nëse është e nevojshme, Komisioni i Licencave e zgjat afatin për dorëzimin e aplikimeve, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë. Vendimi për shtyrjen e afatit për dorëzimin e aplikimeve publikohet në faqen zyrtare të internetit të AMLF-së.

10. Komisioni i Licencave, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e aplikimeve, me kërkesë për sqarim nga një subjekt aplikues, ka të drejtën të bëjë ndryshime në dokumentet e konkurrimit përmes hartimit të një shtojce, e cila publikohet në faqen zyrtare të AMLF-së dhe bëhet pjesë e dokumentit të aplikimit.

Neni 7

Dorëzimi i aplikimeve

1. Aplikimet duhet të dorëzohen dorazi ose me postë në adresën e përcaktuar në njoftimin e konkurrimit, brenda afatit të përcaktuar si afati i fundit për dorëzimin e tyre. Çdo aplikim i dorëzuar pas këtij afati të përcaktuar nuk do të merret në shqyrtim nga Komisioni i Licencave dhe do t'i kthehet i papatur subjektit.

2. Aplikimet do të dorëzohen sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

3. Afati për dorëzimin e aplikimeve është 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike nga data e caktuar në njoftimin e konkurrimit.

4. AMLF-ja është institucioni përgjegjës për ruajtjen e plotë, sigurinë dhe integritetin e tyre, qarkullimin dhe administrimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet aplikuese nga momenti i depozitimit deri në arkivimin e tyre, pas përfundimit të procedurës konkurruese.

Neni 8

Hapja e aplikimeve

1. Hapja e aplikimeve kryhet nga Komisioni i Licencave me asistencën e sekretariati teknik njëkohësisht për të gjithë aplikantët, në datën, vendin dhe orën e përcaktuar për hapjen e aplikimeve të tyre në njoftimin për konkurrim. Procesi i hapjes së aplikimeve duhet të monitorohet në mënyrë të pandërprerë me kamera dhe audio. Aplikantët ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar kanë të drejtën të marrin pjesë në hapjen e aplikimeve.

2. Për çdo aplikim të dorëzuar, lexohet emri dhe adresa e aplikantit, titujt e dokumenteve të paraqitura, numri i plotë i faqeve të tyre, si edhe vlera e ofertës ekonomike. Të gjitha këto të dhëna pasqyrohen në procesverbalin e hapjes së aplikimeve.

3. Procesverbali i hapjes së aplikimeve hartohet dhe nënshkruhet nga Komisioni i Licencave dhe sekretariati teknik. Aplikantëve, propozimet e të cilëve janë hapur, ose përfaqësuesve të tyre të pranishëm do t'u kërkohet të nënshkruajnë procesverbalin e hapjes së aplikimeve. Mungesa e nënshkrimit të aplikantëve në procesverbal nuk cenon vlefshmërinë e procesverbalit.

4. Procedura konkurruese për dhënien e licencës do të vijojë edhe nëse është dorëzuar vetëm një aplikim.

Neni 9

Vlerësimi i aplikimeve

1. Komisioni i Licencave i dorëzon AMLF-së aplikimet e hapura dhe kopje të procesverbalit të hapjes së aplikimeve për të hartuar një relacion mbi dokumentacionin e paraqitur nga subjektet aplikuese. Për të kryer detyrat e saj në zbatim të këtij neni, AMLF-ja ngre një grup pune, i kryesuar nga titullari i këtij institucioni dhe me anëtarë nga punonjësit e strukturave përgjegjëse pranë këtij institucioni.

2. Grupi i punës së AMLF-së verifikon fillimisht pagesën e tarifës së aplikimit nga subjektet aplikuese. Subjektet aplikuese, të cilat nuk kanë kryer pagesën e tarifës së aplikimit, nuk merren në shqyrtim nga grupi i punës.

3. Për aplikantët të cilët kanë kryer pagesën e tarifës së aplikimit, grupi i punës vijon me shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur. Grupi i punës i dërgon Komisionit të Licencave relacionin përkatës i cili përmban informacionin e plotë për secilin subjekt aplikues dhe dokumentacionin e paraqitur në aplikim, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e dokumentacionit. Me kërkesë të grupit të punës, Komisioni i Licencave mund të shtyjë këtë afat edhe për 7 (shtatë) ditë të tjera.

4. Komisioni i Licencave, pas përfundimit të afatit të parashikuar në pikën 3, të këtij neni, administron relacionet përkatëse të grupit të punës për secilin aplikim dhe pas kryerjes së verifikimeve dhe vlerësimeve të dokumentacionit të aplikimit vendos për:

a) refuzimin dhe ndërprerjen e shqyrtimit dhe vlerësimin me pikë të aplikantit/aplikantëve i cili/të cilët nuk ka/kanë dorëzuar në kuptimin formal të gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe/ose nuk ka/kanë kryer pagesën e tarifës së aplikimit;

b) vijimin e shqyrtimit dhe vlerësimin me pikë të aplikantit/aplikantëve i cili/të cilët ka/kanë dorëzuar në kuptimin formal dokumentacionin e plotë dhe ka/kanë kryer pagesën e tarifës së aplikimit.

5. Në rast se gjatë verifikimeve dhe vlerësimeve të dokumentacionit të aplikimit konstatohen pasaktësi ose mangësi formale që nuk ndikojnë në përmbushjen e kriterëve ligjore, Komisioni i Licencave i drejtohet subjektit aplikues për rregullimin e tyre brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e njoftimit të kërkesës.

6. Subjekti aplikues duhet të plotësojë ose të korrigjojë pasaktësitë e konstatuara brenda afatit të caktuar. Kur kërkuesi nuk plotëson ose korrigjon pasaktësitë brenda afatit dhe këto pasaktësi nuk mund të plotësohen ose të korrigjohen nga Komisioni i Licencave, ky i fundit vendos sipas shkronjës "a", të pikës 4, të këtij neni.

7. Çdo kërkesë për rregullimin e pasaktësive dhe çdo përgjigje e subjektit aplikues duhet të dokumentohet në procesverbal, i cili bëhet pjesë përbërëse e procedurës konkurruese.

8. Subjekti ose subjektet aplikuese i cili/të cilat plotësojnë kriteret dhe kanë depozituar dokumentacionin e kërkuar do të renditen në rend zbritës, sipas pikëve të marra në vlerësim sipas nenit 2, të këtij vendimi.

9. Komisioni i Licencave miraton listën e pjesëmarrësve në konkurrim, duke renditur sipas pikëve të marra aplikantët që plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga përfundimi i procesit të përzgjedhjes. Kandidati, i cili ka marrë numrin më të madh të pikëve, shpallet fitues.

10. Lista e pjesëmarrësve në konkurrim, sipas renditjes, dhe njoftimi i fituesit publikohen në faqen zyrtare të AMFL-së.

11. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit subjektet pjesëmarrëse në konkurrim kanë të drejtë të paraqesin ankim te ministri përgjegjës për financat për procedurën e zhvilluar.

12. Nëse ka ankesa gjatë kësaj periudhe, ato do të trajtohen sipas procedurës së përcaktuar në nenin 10, të këtij vendimi.

13. Me përfundimin e afatit për paraqitjen e ankesave dhe shqyrtimin e tyre, Komisioni i Licencave miraton dhënien e licencës, pasi aplikanti i shpallur fitues të ketë paraqitur brenda 30 (tridhjetë) ditëve plotësimin e kriterit të lidhur me fondin e garancisë.

14. Çdo hap i procedurës duhet të dokumentohet dhe të pasqyrohet në procesverbal, i cili duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Licencave dhe grupit të punës së AMLF-së, sipas detyrave përkatëse, të përcaktuara në këtë vendim dhe dokumentacionit të procedurave konkurruese. Në përfundim të procedurës konkurruese, sekretariati teknik harton raportin përmbledhës të procedurës, i cili miratohet nga Komisioni i Licencave.

15. Lista e pjesëmarrësve në procedurën konkurruese, lista e subjektit ose subjekteve aplikuese të kualifikuara dhe renditja e tyre, si dhe njoftimi i fituesit publikohen në faqen zyrtare të AMFL-së.

Neni 10

Ankimi në institucionin përgjegjës

1. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit subjektet pjesëmarrëse në konkurrim kanë të drejtë t'i paraqesin ankim me shkrim ministrit përgjegjës për financat për procedurën e zhvilluar.

2. Ankesa duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe adresën e ankuesit;
- b) referencën e aktit administrativ të kundërshtuar;
- c) bazën ligjore dhe përshkrimin e shkeljes;
- ç) pretendimet dhe dokumentacionin mbështetës.

3. Me marrjen e ankesës me shkrim, ministri përgjegjës për financat pezullon vazhdimin e procedurës së dhënies së licencës, derisa ankesa të jetë shqyrtuar dhe njofton ankuesin dhe Komisionin e Licencave.

4. Ministri përgjegjës për financat, me paraqitjen e ankesës dhe dokumentacionit shoqërues, urdhëron ngritjen e një komisioni *ad hoc*, të përbërë nga jo më pak se 3 (tre) anëtarë nga struktura përgjegjëse për shqyrtimin e ankesave në ministrinë përgjegjëse për financat, për shqyrtimin e ankimit dhe kryerjen e procesit administrativ sipas parimeve të transparencës, paanshmërisë dhe procesit të rregullt ligjor, dhe njofton ankuesin për vendimin e marrë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së ankesës.

5. Komisioni *ad hoc*, një ditë pas miratimit të urdhrimit të ministrit, mblidhet dhe shqyrton ankimin dhe dokumentacionin e depozituar.

6. Komisioni *ad hoc*:

- a) verifikon pranueshmërinë e ankimit (afatin, kompetencën, legjitimitetin, formën);
- b) sipas rastit, siguron të drejtën e ankuesit për t'u dëgjuar;
- c) kërkon informacion shtesë nga organi që ka nxjerrë aktin;
- ç) vlerëson provat dhe, brenda 20 (njëzet) ditëve nga miratimi i urdhrit, harton raportin për ministrin dhe draftvendimin përfundimtar të arsyetuar.

7. Vendimi i ministrit përgjegjës për financat i komunikohet me shkrim ankuesit, jo më vonë se dita e nesërme e punës, pas miratimit të vendimit.

8. Me përfundimin e afatit për paraqitjen e ankesave dhe shqyrtimin e tyre, Komisioni i Licencave miraton dhënien e licencës, pasi subjekti aplikues i shpallur fitues të ketë paraqitur, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, plotësimin e kriterit të lidhur me fondin e garancisë.

Neni 11

Ankimi në gjykatë

Kundër këtij vendimi lejohet paraqitja e ankimit pranë gjykatës kompetente administrative brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e shpalljes së tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Parashtrimi i ankimit në gjykatë nuk pezullon ekzekutimin e këtij vendimi.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 12

Institucionet/organet që ngarkohen për zbatimin

Ngarkohen Ministria e Financave, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe Komisioni Licencimit për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama